



Gender Alliance for Development Center  
**Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim**



# **Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore**

## **Bashkia Durrës**

### **2017**

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

#### **Autorët**

Mirela Arqimandriti

Rrezarta Agolli

Megi Llubani

-

## Tabela e përmbajtjes

<b>SHKURTIME</b> .....	<b>4</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>7</b>
<b>TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKINË DURRËS</b> .....	<b>9</b>
<b>MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020</b> .....	<b>11</b>
<b>GJETJET KRYESORE</b> .....	<b>11</b>
<b>TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË DURRËS</b> .....	<b>13</b>
<b>REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017</b> .....	<b>14</b>
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	14
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA. ....	21
<b>REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË DURRËS</b> .....	<b>22</b>
<b>ANEKSE</b> .....	<b>23</b>
ANEKSI 1- DETYRAT E KOORDINATORIT PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE.....	23
ANEKSI 2- DETYRAT E TË GJITHË ANËTARËVE QË KANË NËSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT SI PJESTARË TË MEKANIZMIT TË RREFERIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE .....	24

## Lista e tabelave

Tabela 1. Të dhëna në lidhje me njësitë administrative të Bashkisë Durrës .....	9
Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e bashkisë Durrës .....	10
Tabela 3. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Durrës .....	13
Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre .....	15
Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve në Bashkinë Durrës .....	19
Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Durrës .....	20
Tabela 7. Koordinatori Vendor kundër DhBGj në Bashkinë Durrës .....	20
Tabela 8. GTN-ja e Bashkisë Durrës .....	20

## Shkurtime

<b>ASPA</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BGj</b>	Barazia Gjinore
<b>DhBGj</b>	Dhunë me bazë Gjinore
<b>DhF</b>	Dhunë në Familje
<b>DhKG</b>	Dhunë ndaj Grave
<b>GTN</b>	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave në Shqipëri
<b>IZhA</b>	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
<b>KONVENTA CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>KONVENTA E STAMBOLLIT</b>	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>KD</b>	Komiteti Drejtues
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MKR</b>	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
<b>MRR</b>	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
<b>(MMSR)MShMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>NBGj</b>	Nëpunës i Barazisë Gjinore
<b>NjVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>OJF</b>	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
<b>OShC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>OSCE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PKV</b>	Plani Kombëtar i Veprimit
<b>PShSh</b>	Policia e Shtetit Shqiptar
<b>QAGjZh</b>	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
<b>QZhK “Sot për të Ardhmen”</b>	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
<b>REVALB</b>	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
<b>RrFGSh</b>	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
<b>SKBGj</b>	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
<b>ShGPS</b>	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
<b>UM</b>	Urdhër Mbrojtjeje
<b>UMM</b>	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>UN WOMEN</b>	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

**Projekti** “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përvec manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

### ***Rreth organizatave zbatuese***

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për bashkinë e Durrësit raporti u hartua me ndihmën e eksperteve Rrezarta Agolli dhe Bajana Cevoli të Shoqatës së Grave me Probleme Sociale (ShGPS). Ndërsa monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të referimit u krye nga dy eksperte të pavarura Erisilda Shpata dhe Greta Çela. ShGPS është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 1999, e cila operon në Qarkun e Durrësit. Ajo ka si qëllim promovimin e barazisë gjinore në shoqëri si dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marxhinalizuara të grave në këtë Qark. Dhuna në familje, barazia gjinore, pjesëmarrja aktive e gruas në vendim-marrje, si dhe integrimi i komuniteteve të zonave informale në jetën social-kulturore të qytetit janë çështjet kryesore në fokus të punës së kësaj organizate. Për më shumë se një dekadë, ShGPS ka ofruar një gamë të gjërë shërbimesh për grupet vulnerabël të grave të këtij Qarku, shërbime të cilat kanë konsistuar në: shërbime psiko-sociale, shërbime ligjore, shërbime mjekësore si dhe në informim dhe ndërgjegjësim.

### ***Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?***

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që

garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatohet një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

## Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-20-20 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjodhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:

- Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
- Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
- Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikën pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rasteve të dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën [www.revalb.org](http://www.revalb.org)

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.



## Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë Durrës

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

**Tabela 1. Të dhëna në lidhje me njësitë administrative të Bashkisë Durrës**

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Durrës	Durrës	<b>Ishëm</b>	Fshatrat: Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj
		<b>Manëz</b>	Qyteti Manëz, Fshatrat: Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz
		<b>Sukth</b>	Fshatrat: Qyteti Sukth, Fshatrat: Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori
		<b>Katund I Ri</b>	Fshatrat: Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik
		<b>Rrashbull</b>	Fshatrat: Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj
		<b>Durrës</b>	Qyteti Durrës

Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

**Figura 1. Harta e Bashkisë Durrës**



Burimi: UNDP, STAR 2 project.

Në Bashkinë e Durrësit jetojnë 92,365 familje dhe numërohen 39 fshatra, ku numri më i madh është i përqendruar në njësinë administrative Ishëm dhe Katund i Ri me 9 fshatra përkatësisht. Përqendrimi më i madh i familjeve shihet në Njësinë Administrative Durrës, me 67,286 ndjekur nga Rrashbulli dhe Sukthi. Ekziston një hendek i madh ndërmjet popullsisë së raportuar sipas Censurit të vitit 2011 dhe regjistrit civil i cili numëron pothuajse dyfishin e popullsisë. Sikurse me bashkitë e tjera kjo shpjegohet nga shifra e lartë e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, karakteristikë e shumicës së territorit të Shqipërisë. Popullsia më e madhe i përket qytetit të Durrësit që përmban 65% të gjithë popullsisë të shpërndarë në njësitë e tjera administrative. Njësia e dytë me popullsinë më të madhe është Rrashbulli ndjekur nga Sukthi.

**Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e bashkisë Durrës**

Njësitë administrative	Numri i fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil 2016
<b>Ishëm</b>	9	2389	5001	8938
<b>Manëz</b>	7	3058	6,652	11744
<b>Sukth</b>	6	7330	15,966	27841
<b>Katund I Ri</b>	9	4306	10,161	15896
<b>Rrashbull</b>	8	7996	24,081	30212
<b>Durrës</b>		67286	113249	214559
<b>Totali</b>	<b>39</b>	<b>92365</b>	<b>175110</b>	<b>309190</b>

*Burimi: UNDP, STAR 2 project.*

Në total 1,169 familje, ose 1.2% e familjeve në Bashkinë e Durrësit përfitojnë nga programi i Ndhmës Ekonomike, fondi total i të cilës është 226,479,357 lekë. Përqendrimin më të madh kjo kategori e ka në njësitë administrative Sukth, Durrës dhe Katund i Ri. Bie në sy që në njësitë e tjera administrative nuk ka asnjë familje përfituese të ndihmës ekonomike.

Në territorin e Bashkisë së Durrësit jetojnë 8,978 persona me aftësi të kufizuara dhe 1,912 kujdestarë të regjistruar, që do të thotë se raporti ndërmjet tyre është 1 kujdestar për 5 persona me aftësi të kufizuara. Fondi total i pagesës së paaftësisë është 148,732,193 lekë or 16,566 lekë për person. Ndarja e tyre në njësitë administrative është pothuajse në përpjestim të drejtë me numrin e popullsisë. Edhe këtu bie në sy që në njësinë administrative Rrashbull nuk ka asnjë person të regjistruar që i përket kësaj kategorie.

Në territorin e Bashkisë së Durrësit gjenden gjithsej 36 kopshte, gjysma e të cilave janë të përqendruara në njësinë administrative Durrës. Numri total i fëmijëve të regjistruar është 3,810 përkundër 132 edukatorëve, që do të thotë se raporti ndërmjet tyre është 1 edukator për 29 fëmijë.

Numri total i shkollave 9-vjeçare është 73, ku më shumë së gjysma gjenden në njësinë administrative të Durrësit. Numri total i nxënësve të shkollave 9-vjeçare është 24,431 përkundër 1,389 mësuesve, që do të thotë se raporti ndërmjet tyre është 1 mësues për 18 nxënës. Numri total i shkollave të mesme është 32, me 78% prej tyre të përqendruara në njësinë administrative të Durrësit. Numri total i nxënësve është 9,530 përkundër 580 mësuesve, që do të thotë se raporti ndërmjet tyre është 1 mësues për 16 nxënës.

Me përjashtim të njësisë administrative Durrës e cila është e pajisur me 9 qendra shëndetësore, njësitë e tjera administrative përmbajnë secila nga 1 qendër shëndetësore. Ndërkohë numri total i ambulancave, përkundër pritshmërive është shumë më i lartë në Ishëm, me 12 të tilla në shërbim, krahasuar me 3 në Durrës, që përbën edhe numrin më të ulët nga njësitë administrative. Nga 795 mjekë të përgjithshëm dhe infermierë në Bashkinë e Durrësit, 84% gjenden në njësinë administrative Durrës.

## **Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020**

***Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.***

### **Gjetjet kryesore**

- Mekanizmi vendor për rastet e dhunës në familje<sup>1</sup> nuk ka funksionuar siç duhet përgjatë vitit 2017. Është zhvilluar vetëm një mbledhje e GTN dhe asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues (KD). Megjithatë vetë zyra e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje pranë bashkisë Durrës ka trajtuar rreth 50 raste të dhunës në familje me të gjitha detajet përkatëse duke koordinuar me institucionet përgjegjëse.
- Numri total i rasteve të trajtuara në lidhje me çështjet e dhunës në familje në vitin 2017 është 14 raste të përfaqësuara në gjykatë për UMM/UM, 10 raste të mbështetura gjatë zgjidhjes së martesës për shkaqe të dhunës në familje dhe 40 raste të cilat kanë përfituar këshillim psikologjik e ligjor për dhunën në familje dhe masat mbrojtëse kundrejt 323 urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) të lëshuar gjatë atij viti nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për gra të cilat banojnë në bashkinë e Durrësit.
- Për vitin 2017 buxheti i bashkisë për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 1,094,470 lekë prej të cilave 404,000 lekë i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” (QZHK), ndërsa pjesa tjetër shërben për të mbuluar pagat për 3 nëpunëse të Barazisë Gjinore (NBGj) që paguhen specifikisht nga buxheti i bashkisë Durrës dhe që midis punëve të tjera kanë përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor kundër

---

<sup>1</sup> “Mekanizmat vendorë për rastet e dhunës në familje”. Sipas VKM Nr. 334, datë 17. 2. 2011 “Për mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij”, mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) Ekipet teknike ndërdisiplinore; c) Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie. Komitetet drejtuese kryesohen nga Kryetari i Bashkisë dhe në përbërje kanë: a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë; b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor; c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit; ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore; d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik; dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë; e) Përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në komunë; ë) Përfaqësuesin e zyrës së përmbartimit; f) Përfaqësuesin e prefekturës; g) Kryetarët e komunave që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki; gj) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit; h) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje; i) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore, ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë; j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; k) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

Dhunës në Familje: drejtoresha e shërbimit social dhe 2 specialiste për barazinë gjinore e dhunën në familje, një për bashkinë Durrës dhe një për njësinë administrative Sukth.

- Bashkia e Durrësit nuk ofron shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe as për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore. Ngritja e një qendre emergjence është diskutuar së fundmi, por nuk ka ende një angazhim konkret për këtë. Pjesa më e madhe e shërbimeve ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile. Për rrjedhojë, burimet njerëzore, financiare dhe operacionale si të aktorëve publik ashtu edhe jofitimprurës duhen bashkërenduar për të krijuar mekanizma të përbashkët për ofrimin e shërbimeve.
- Nuk ka dokumentacion të rregullt sa i përket funksionimit të mekanizmit të referimit si edhe aktivitete të tjera që i përkasin fushës së luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Monitorimi nxorri në pah se niveli i transparencës në ndarjen e këtij informacioni me aktorë të tjerë të interesuar ishte i ulët.
- Nuk ka pjesëmarrje të plotë të të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje dhe as aksione të koordinuara midis tyre. Mungojnë, veçanërisht institucionet gjyqësore, të cilat më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, sidomos bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Roli i nëpunësit të barazisë gjinore, përgjatë vitit 2017 ishte i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore. Për rrjedhojë, shoesh herë përgjigja kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë.
- Bashkia e Durrësit nuk ka shpenzuar asgjë gjatë vitit 2017 për rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje apo të organizaonjë aktivitete ndërgjegjësuese si pankarta, fletëpalosje ku të flitet për dhunën dhe të jepen numrat kombëtarë të institucioneve që adresojnë dhunën në familje në Shqipëri. Në lidhje me këtë vetëm organizatat e shoqërisë civile kanë realizuar aktivitete dhe kanë prodhuar materiale ndërgjegjësuese. Sidoqoftë bashkia duhet të kujdeset për këtë duke alokuar buxhet specifik dhe marrë masa që informacioni të shpërndahet në njësitë administrative.
- Niveli i bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe policisë në kuadër të mekanizmit të referimit ka qenë i pamjaftueshëm. Ka mungesë komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve për referimin sa më efikas të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Rritja e komunikimit ndërmjet këtyre dy institucioneve është prioritarë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës.
- Evidentohet gjithashtu se njësitë e mbrojtjes së fëmijës mblidhen çdo muaj, dhe rastet e viktimave të dhunës në familje ku fëmijët janë të prekur apo dëshmitarë të dhunës në familje janë referuar dhe menaxhuar tek njësitë e mbrojtjes së fëmijës.
- Nuk ka asnjë organizatë në bashkinë Durrës që të merret me dhunuesit për tu dhënë mundësinë e rehabilitimit, përmes programeve të specializuara.
- Në bashkinë Durrës funksionon linja telefonike 24 orëshe falas për viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore e cila është afishuar në dy institucionet kryesore të Mekanizmit të Referimit të Raseve (MRR), si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ashtu edhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

## Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Durrës

Qarku Durrësi renditet i dyti pas qarkut të Tiranës për numrin e grave që raportojnë dhunë në familje për vitin 2017 duke zënë kështu 13.9% të të gjitha rasteve të raportuara në nivel vendi bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT). Numri i grave të dhunuara në raport me numrin e popullsisë është më i lartë në qarkun e Durrësit, Vlorës dhe Tiranës me normë përkatësisht 32; 27 dhe 26 të dhunuara për 10 mijë banore gra.<sup>2</sup>

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Durrës ka në përbërjen e saj 3 komisariate: Komisarjati i Policisë Durrës, Krujë e Shijak dhe 3 stacione policore: Fushë Krujë, Manzë dhe Plepa Plazh. Të gjitha të dhënat mbledhen e përpunohen në Drejtorinë Vendore të Policisë së qarkut Durrës. Gjatë vitit 2017 janë evidentuar gjithsej 603 raste të dhunës në familje me 613 autorë, nga të cilët 48 autorë të arrestuar në flagrancë, 540 autorë ndiqen në gjendje të lirë, 21 autorë janë të shpallur në kërkim, 3 autorë të ndaluar, dhe 1 autor i vetëvrarë.

Gjatë vitit 2017 janë lëshuar 327 kërkesë padi për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes pas 400 rasteve të evidentuara. 51 raste janë vepra penale sipas nenit 130/a, me 23 autorë të arrestuar, 20 autorë që ndiqen në gjendje të lirë, dhe 5 autorë të shpallur në kërkim, 5 autorë të ndaluar dhe 1 autor i vetëvrarë.

**Tabela 3. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Durrës**

Dhuna në familje	Bashkia Durrës
Raste te evidentuar	400
Vrasje raste	2
Viktima	3
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	327
Shkelje Urdhër Mbrojtje	7
Vepër penale- Neni 130/a	51
Autorë të arrestuar	23
Autorë të ndaluar	5
Autorë të shpallur në kërkim	5
Autorë në gjendje të lire	20
Autorë të vetëvrarë	1

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit*

Statistikat janë formuar në bazë të numrit të çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, çështjet e regjistruara për herë të parë si dhe ato të kthyera për rigjykim nga Gjykata e Apelit Durrës.

Kështu, për të marrë në analizë vitin 2017, sipas të dhënave të publikuara, rezulton se numri i çështjeve të mbartura (në vijimësi) nga viti 2016 është 44, çështje të regjistruara të reja janë 17, të ardhura pas prishjes (rigjykime sipas Gjykatës së Apelit) janë 2, në total janë 63. Nga këto 63, kanë përfunduar gjykimin duke u zgjidhur martesë vetëm 10 kërkesë padi, pjesa tjetër janë të pushuara për mosparaqitje pale, të pajtuara (palët kanë hequr dorë gjatë gjyimit), ose nuk janë përfunduar si çështje. Po ashtu, Gjykata ka përcaktuar edhe faktin se sa prej kërkesë padive janë

<sup>2</sup>INSTAT. 2018. Burra dhe Gra 2018. Online: <http://WWW.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteve-statistikore/burra-dhe-gra-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2018/>

të inicuar nga femrat dhe sa nga meshkujt, në vitin konkret 7 padi rezultojnë të ngritura nga bashkëshortja.

## Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

### Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia e Durrësit ka një prej niveleve më të larta të raportimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Për rrjedhojë rritja e ndërgjegjësimin të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje duhet të jetë objektiv parësor për veprimtarinë e bashkisë në këtë fushë. Nga monitorimi i zbatimit të strategjisë rezultojnë se rolin kryesor në fushat ndërgjegjësuëse në bashkinë e Durrësit e kryejnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që punojnë në territorin e bashkisë.

Në vitin 2017, bashkia Durrës ka nënshkruar “Kartën Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Jetën Vendore”. Më tej, Bashkia Durrës ka 2 marrëveshje bashkëpunimi me dy organizata të shoqërisë civile me Shoqatën e Grave me Probleme Sociale Durrës e cila jep vullnetarisht ndihmë për gratë dhe vajzat me probleme sociale të referuara nga bashkia Durrës si dhe me e cila mbështetet financiarisht nga Bashkia për tre shërbime.

Insitucionet vendore dhe OJF-të të cilat operojnë në qytetin e Durrësit janë pjesë e MKR-së Durrës që prej vitit 2009.

Bashkia Durrës ka bashkëpunime me UNDP dhe UNWomen; dy nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe promovojnë fuqishëm barazinë gjinore si dhe mbështetin shtetin shqiptar dhe organizatat jo qeveritare në luftën kundër dhunës në familje.

Për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore, Bashkia Durrës është mbështetur nga UN Women për ngritjen e mekanizmit kundër dhunës në familje në vitin 2010-2012. Gjithashtu UN Women ka ndihmuar bashkinë Durrës gjatë nënshkrimit të “Kartës Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Jetën Vendore”

Në bashkëpunim me Rrjetin RRIS (anëtarë të të cilit janë Bashkia Durrës, World Vision, QZHK, World Hope, Shpresë e Gjallë) në Bashkinë Durrës janë zhvilluar programe edukimi familjar me familjet në nevojë për parandalimin e dhunës në familje dhe rritjen e barazisë gjinore brenda njësisë familjare. Nga ky program kanë dalë raste të suksesshme të familjeve që kanë dalë nga cikli i dhunës dhe janë promovuar si raste suksesi nga programet e UNDP-së. Programi ka një kohë shtrirje për 7 muaj, duke organizuar takime të rregullta çdo muaj dhe duke u zbatuar ky program prej 5 vitesh në zonat periferike të qytetit si: Këneta dhe Spitalla.

UNDP ka ndihmuar për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të Bashkisë që merren me çështjet e dhunës në familje. Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2017 përfaqësues nga Bashkia Durrës kanë marrë pjesë në një komunikim me Web- binar me Korenë e Jugut në lidhje me funksionimin e mekanizmit të dhunës dhe mbrojtjen që u garantohej viktimave të dhunës. Më tej, me ndihmën e UNDP është lehtësuar një takim ku janë diskutuar çështje të zbatueshmërisë së Ligjit për masa ndaj dhunës në familje, vështirësitë që kanë koordinatorët në menaxhimin e rasteve si dhe rekomandimet e GREVIO-s<sup>3</sup> adresuar Shqipërisë në nëntor 2017.

<sup>3</sup> GREVIO është organi i pavarur i ekspertëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) nga Palët. GREVIO do të hartojë dhe publikojë raporte për vlerësimin e masave legjislativë dhe të tjera të marra nga

Të dhënat e mbledhura në lidhje me zbatimin e objektivit 3.1 pasqyrohen sipas takimeve të renditura në vijim:

- Trajnim mbi “Mbrotjen e Fëmijëve nga Trafikimi dhe Shfrytëzimi”, realizuar në datë 06.04.2017 në ambientet e Bashkisë Durrës, me qëllim rritjen e njohurive mbi konceptet dhe procedurat në lidhje me mbrotjen e fëmijëve në rrezik dhe atyre të trafikuar dhe/ose shfrytëzuar. Trajnimi u realizua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Agjencia Shtetërore për Mbrotjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF). Gjatë takimit pjesëmarrësit u njohën me legjislacionin për trafikimin/ shfrytëzimin e fëmijëve, mekanizmat dhe përgjegjësitë e identifikimit dhe referimit të tyre, intervistimi dhe etika, ndërhyrjet dhe ndihma e nevojshme, si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional për vlerësimin e situatës dhe planifikimit të ndërhyrjes.
- Dëgjësë Publike, organizuar në datë 10.05.2017, në kuadër të nismës së Bashkisë Durrës për përgatitjen dhe hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2018-2020, si dhe në kuadër të transparencës publike lidhur me të gjitha projektet, shërbimet dhe investimet e realizuara nga bashkia përgjatë vitit në vazhdim.
- Angazhimi kryesor i bashkisë për ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore ka qenë në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit. Në rastet e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore mbetet sfida angazhimi më i madh dhe i qendrueshëm nga ana e bashkisë për ndërgjegjësimin e popullsisë në bashkërendim edhe me organizata të shoqërisë civile në territorin e saj si dhe përcaktimi i buxheteve të dedikuara në buxhetet vjetore të bashkisë..
- Organizatat më aktive të shoqërisë civile që veprojnë në Durrës kundër dhunës me bazë gjinore janë Shoqata e Grave me Probleme Sociale dhe Qendra për Zhvillim Komunitar “ Sot për të Ardhmen”.
- Në qytetin e Durrësit që në vitin 2017 janë ngritur dy Klinika Ligjore falas, një pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës dhe një pranë Universitetit “Aleksandër Mosiu” Durrës. Të dyja Klinikat Ligjore janë ngritur me financim të organizatave e fondacioneve.
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale ka qenë pjesëmarrëse në 19 takime ku ka pasur përfaqësues të Bashkisë Durrës dhe përfaqësues nga Policia. Si më poshtë renditur pasqyrohen të gjitha takimet e mbajtura përgjatë vitit 2017.

**Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre**

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	30-31.03 2017	Restorant Arragosta	Trajnim: “ <i>Bashkëpunim Institucional për Forcimin e Mekanizmit të Referimit të Dhunës në Familje.</i> ”	ShGPS
2	30.10.2017	Bashkia Durrës	Takim i MRDHF	Bashkia Durrës
3	12.06.2017	Salla e Këshillit Bashkiak	Workshop- “ <i>Draft Raport mbi MRDHF</i> ”	ShGPS
4	22.12.2017	Restorant Arragosta	Workshop- “ <i>Raporti i monitorimit të MRDHF, në Bashkinë Durrës.</i> ”	ShGPS

palët për të dhënë efekte në dispozitat e Konventës. Në rastet kur kërkohet veprimi për të parandaluar një model serioz, masiv ose të vazhdueshëm të çdo akti të dhunës të mbuluar nga Konventa, GREVIO mund të iniciojë një procedurë hetimore të posaçme. GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi temat dhe konceptet e Konventës.

5	06.12.2017	Restorant Arragosta	Workshop- <i>“Dhuna ne Familje, problem i mprehtë social.”</i>	ShGPS
6	01.02.2017	Bashkia Durrës	Analiza dhe Raporti i vitit 2016 mbi Fëmijët në Situata Rruge, si dhe sfidat/planet për të ardhmen.	Bashkia Durrës
7	08.02.2017	Qendra për Shërbime me Bazë Komunitare për Fëmijët me aftësi të Kufizuar, seksion i Banesave Sociale me Qera, Lagja 17, Durrës.	Takim në kuadër të Reformës së re të Shërbimeve Sociale, prezantim i Planit të Përkujdesit Social të Bashkisë, nënshkrimi i një Pakti Social nga Kryetarët e Bashkive të Qarkut Durrës	Bashkia Durrës
8	07.12.2017	Salla e Këshillit të Qarkut Durrës	Prezantim i Planit Lokal të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, në Bashkinë Durrës	Bashkia Durrës në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim
9	24.04.2017	As Hotel Golem	Rishikim dhe Planifikim me në Fokus Mirëqënien e fëmijëve në zonat ku ne punojmë.	World Vision
10	15.05.2017	Pallati i Kulturës	Forum <i>“Lumturia Fillon ne Familje”</i>	RRIS
11	16.03.2017	QZHK <i>“Sot për të Ardhmen”</i>	Takim me grupin RRIS	World Vision
12	07.04.2017	Zyrat e URT-s	Takim me grupin RRIS	
13	02.02.2017		Reflektim mbi takimin e parë me familjet për <i>“Vitin e familjes”</i> dhe trajnimin të <i>“Celebrating Families”</i>	RRIS
14	06.04.2017	Salla e Këshillit Bashkiak, Durrës	Trajnim mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Trafikimi dhe Shfrytëzimi	OSCE dhe Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
15	16.03.2017	Bashkia Durrës	Nënshkrimi i Kartës Europiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Nivel Vendor.	Bashkia Durrës
16	04.04.2017	Prefektura Durrës	Takimi i KRAT-Komiteti Rajonal Antitrafik	Prefektura Durrës
17	08.05.2017	Salla e Këshillit Bashkiak	Mekanizmi i Referimit-Suksese dhe Sfida 2010-2017	Bashkia Durrës, World Vision Sëdesh International Development



				Cooperation Agency Sida, Mekanizmi i Referimit të Dhunës
18	10.05.2017	Salla e Këshillit Bashkiak	Dëgjesë Publike mbi Buxhetin 2018-2020	Bashkia Durrës
19	15.02.2017	Pallati i Kulturës Durrës	Takim me Shoqërinë Civile per projektin “Veliera”	Bashkia Durrës
20	22.12.2017	Restorant Arragosta	Sesion informimi “Monitorimi i Strategjise Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020.”	ShGPS

**Burimi: ShGPS**

QSHK është një tjetër organizatë shumë aktive në Durrës. Më poshtë të detajuara paraqiten aktivitetet e organizuara nga kjo shoqatë, në të cilat përfaqësuesit e bashkisë Durrës kanë qenë pjesëmarrës.

- 30.1.2017: QZhK "Sot për të ardhmen" në ish kënetën e Durrësit, vijon promovimin e produkteve të grupeve komunitare, veçanërisht të grave tek partnerët gjermanë, për t'i bërë të aksesueshme edhe në tregjet ndërkombëtare.
- 8.3.2017: Aleanca e Grave të këshillit bashkiak Durrës, me Kryetaren znj. Liri Kërtusha, së bashku edhe me anëtare të tjera, iu bashkuan aktivitetit me temë “Panairi për 8 Mars – Manifesto - Kontribuo dhe ti” në dobi të viktimave të dhunës e fuqizimit ekonomik të grave.
- 25.3.2017: Aktiviteti “Kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi ndryshe.”
- 25.4.2017: QZhK organizoi së bashku me të rinjtë e Shkollës “E Re”, në ditën Portokalli, një ndeshje miqësore për barazinë gjinore.
- 22.5.2017: Organizuar aktiviteti me temë “Shkëmbim eksperiencash në kuadër të fuqizimit ekonomik të grave”. Grate aktiviste të QKZH morën pjesë në panairin me punime dore të Mirjetës në Klubin e Artit SIGAL UNIQA.
- 17.06.2017: U mundësua takimi i kandidatëve për deputete, të vajzave dhe grave për të drejtat e tyre për të votuar dhe për të qenë pjesë e vendimmarrjes.
- 25.7.2017: Aktivistë të “Sot për të Ardhmen” ndërgjegjësuan të rinjtë dhe qytetarët e Durrësit mbi dhunën kibernetike ndaj vajzave dhe grave.
- 25.10.2017 me vajza dhe gra rurale u zhvillua pranë World Vision Workshopi mbi dhunën ndaj vajzave dhe grave rurale dhe shërbimet e ofruara nga Mekanizmi i Referimit.
- 25.10.2017: Organizuar aktiviteti me temë “Dita portokalli, 25 Tetor "Dhuna ndaj grave rurale”.
- 21.11.2017: Në Ditën Universale të Konventës së OKB për të Drejtat e Fëmijëve u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak një takim i organizuar nga Bashkia Durrës dhe GTN.
- 25.11.2017: Në Qendrën ditore të të moshuarve u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues “Dhuna ndaj grave të moshuara”.
- Hapja zyrtare e 16 ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore u bë në qendrën e QZHK në ish Kënetë.
- 24.12.2017: Në qendren “Sot Për Të Ardhmen” është organizuar takimi me temë: “Gratë e vajzat, agjente ndryshimi për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave e vajzave”

- Tetor-dhjetor 2017 janë zhvilluar nga World Vision Workshope mbi barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje me të rinjtë e Shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, si “Dom Nikoll Kaçorri”, Shkolla “E Re” etj.
- Nëntor-dhjetor 2017 është zhvilluar fushatë intensive mediatike për eliminimin e dhunës ndaj vajzave dhe grave në median vizive kombëtare, lokale, të shkruar, sociale, si: VOA - Zëri i Amerikës, ABC NeWs, TV Vision, Lajme Shqip, etj.
- Në përgjithësi edhe aktivitetet e OJF-ve janë në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, Drejtorinë e Shërbimit Social, Koordinatorin Vendor për Dhunën, NJMF, Qendrat komunitare etj.

QZHK ofron gjithashtu Shërbimin Psikologjik e Ligjor falas. Kjo shoqatë ofron linjën telefonike falas: **08009888**

Në lidhje me angazhimin e komunitetit fetar duhet përmendur se ekzistojnë disa organizma fetarë që janë aktivisht të angazhuar në adresimin e dhunës në familje si p.sh Shoqata World Hope, World Vision, Shpresa e Gjallë, Qendra Kristiane etj.

**Objektivi 3.1** i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta. Një bashkëpunim i tillë ende nuk është institucionalizuar, megjithatë ka kontakte ad – hoc dhe ndërveprim ndërmjet strukturave të ndryshme lokale dhe këtyre organizatave. Shpesh këto organizata ofrojnë shërbime komplementare ndaj atyre që bashkia nuk i ofron dot. Fokusi kryesor i aktiviteteve të tyre është ndërgjegjësimi dhe puna për nxitjen e një familjeje të shëndetshme.

**Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.**

Mekanizmi i referimit nuk ka funksionuar në mënyrë të rregullt përgjatë vitit 2017 megjithëse ky mekanizëm është ngritur që në vitin 2010. Marrëveshja e bashkëpunimit "Për krijimin e Sistemit të Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje në Durrës" në bazë dhe për zbatimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare" është lidhur në datë 08/03/2010. Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë mbledhje të Komitetit Drejtues dhe vetëm një mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar, në datë 12 qershor 2017. Ndërsa mbledhjet e Grupit Teknik Multidisiplinar mbahen rregullisht dhe trajtojnë rastet e fëmijëve, një pjesë e të cilëve janë të përfshirë në rastet e dhunës në familje. Përgjatë monitorimit u vërejt se nuk mbahen minutat e takimeve në mënyrë të rregullt dhe nuk ka pothuajse asnjë dokumentacion për diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e mekanizmit. Numri total i rasteve të trajtuara në lidhje me çështjet e dhunës në familje në vitin 2017 është 14 raste të mbështetura me mbrojtje ligjore në gjykatë gjatë lëshimit të UMM/UM, 10 raste zgjidhjeje martese për shkak të dhunës në familje, të asistuar gjatë procesit gjyqësor dhe 40 raste-viktima të dhunës në familje që kanë marrë këshillim psikologjik e juridik, integrim e fuqizim ekonomik.

Pjesëmarrës në takimin e GTN kanë qenë Bashkia Durrës, Shërbimet Shëndetësore, Policia, Drejtoria Arsimore dhe tre organizata të shoqërisë civile. Nga ana tjetër Prokuroria, Gjykata, Shërbimi Përmbarrimor, Zyra e Punës dhe Shërbimi i Provës rrallëherë marrin pjesë në këto takime.

Nga të dhënat e monitorimit vihet re gjithashtu se për funksionimin e bashkisë përgjatë vitit 2017 buxheti alokon pagën e Koordinatorit Vendor të dhunës. Pozicioni i Koordinatorit Vendor është krijuar që prej vitit 2007. Aktualisht personi përgjegjës për këtë pozicion kryen detyra të tjera, gjë e cila cënon performimin e detyrave të koordinatorit të përcaktuar me ligj dhe rregulloren e Bashkisë. Për rrjedhojë, është e domosdoshme të rishikohet roli i koordinatorit aktual që të mos ketë mbivendosje dhe lënie pas dore të funksioneve të rëndësishme të koordinatorit. Sistemi i referimit të rasteve përditësohet në mënyrë të përditshme, megjithatë nuk është ndarë informacion mbi shpeshësinë e raportimit të rasteve tek institucione të tjera.

Në njësinë administrative Sukth është hapur një pozicion me emërtimin “Inspektore për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje “e cila e kryen punën e saj 3 ditë në Sukth dhe 2 ditë në Durrës

Përgjatë vitit 2017 është zhvilluar një trajnim për anëtarët e MKR në muajin mars. Ky trajnim është zhvilluar nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale përgjatë dy ditëve. Në trajnim morën pjesë të gjithë administratorët e njësive administrative të bashkisë. Qëllimi ishte ndarja e informacionit në lidhje me dhunën në familje, kryesisht duke iu referuar faktorëve në kontekstin shqiptar, shkaqet dhe pasojat e dhunës, veçanërisht tek gratë dhe fëmijët si edhe informacion mbi shërbimet ekzistuese për këtë target grup. Një rëndësi specifike i është kushtuar edhe funksionimit të mekanizmit të referimit, duke specifikuar në këtë kuadër edhe përgjegjësitë e secilit aktor të përfshirë.

### **Bashkëpunimi i bashkisë së Durrësit me policinë ka munguar përgjatë vitit 2017.**

Bashkëpunimi me Zyrën e Punësimit, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Shërbimin Social ka qenë i suksesshëm përgjatë vitit 2017. Megjithatë nga monitorimi vihet gjithashtu në dukje mungesa e dokumentacionit për rastet e ndjekura që nuk lejojnë një analizë të plotë të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve dhe bashkisë në kuadër të trajtimit të rasteve të referuara. Bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale qenë i suksesshëm në zhvillimin e aktiviteteve dhe fushtave ndërgjegjësuese mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

Gjatë vitit 2017 10 punonjës të Njësive Administrative janë përfshirë në trajnime për dhunën në familje. Për vitin 2017 buxheti i bashkisë për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 404,000 lekë të cilat i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” përmes 3 zërave, ndihmë ligjore 20,000 leke/muaj; ndihmë psikologjike 15,000 leke/muaj; linja telefonike 7,000 leke/muaj. Gjithashtu janë dhe tre funksionarë që paguhen specifikisht nga buxheti i Bashkisë Durrës për problemet e barazisë gjinore e dhunës në familje: Drejtoresha e Shërbimit Social dhe 2 specialistë për barazinë gjinore e dhunën në familje, një për bashkinë Durrës dhe një për njësinë administrative Sukth. Buxheti arrin shumë prej 690,470 lekë në vit për pagat e tre punonjësve të sipërpërmendur.

**Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve në Bashkinë Durrës**

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	Nuk ka informacion
2015	Nuk ka informacion
2016	Nuk ka informacion
2017	1

**Burimi: Bashkia Durrës**

**Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Durrës**

Viti	Mbledhjet e KD
2014	Nuk ka pasur mbledhje
2015	Nuk ka pasur mbledhje
2016	Nuk ka pasur mbledhje
2017	Nuk ka pasur mbledhje

**Burimi:** *Burimi Bashkia Durrës*

**Tabela 7. Koordinatorit Vendor kundër DhBGj në Bashkinë Durrës**

Viti	Koordinatorit Vendor kundër DhBGj
2014	Aurora Hyka
2015	Aurora Hyka
2016	Aurora Hyka, Mihane Pashnjari
2017	Aurora Hyka, Mihane Pashnjari

**Burimi:** *Bashkia Durrës*

Pozicioni i Nëpunësit për për Barazinë Gjinore në bashkinë e Durrësit është krijuar në vitin 2012 dhe detyrat janë kryer nga i njëjti person që prej emërimit të saj si specialiste e lartë për dhunën në familje. Prej vitit 2013 iu shtua detyra e specialistes së barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Rreth 90% të kohës Koordinatorit Vendor ia kushton dhunës në familje, megjithatë ngarkesa me tre role të ndryshme përbën pengesë për performimin e të gjitha roleve dhe përgjegjësi për secilin prej pozicioneve që mbulohet nga ky person.

Detyrat e Koordinatorit Vendor janë specifikuar edhe në Rregulloren e re të Bashkisë Durrës. Kjo rregullore është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.<sup>4</sup>

GTN-ja e Bashkisë Durrës përbëhet nga përfaqësues të institucioneve sipas tabelës më poshtë:

**Tabela 8. GTN-ja e Bashkisë Durrës**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia	Meme Xhaferraj drejtore e shërbimit social Aurora Hyka, NBGj bashkia Durrës Mihane Pashnjari, NBGj Njësia administrative Sukth
Drejtoria e Policisë	Jonida Kongjoni specialiste
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Joana Qelesi (kryetare )
Prokuroria e Rrethit	Nuk është dhënë emri
Drejtoria Arsimore Rajonale	Lindita Mukaj
Drejtoria e Shëndetit Publik	Kristo Huta
Zyra e Përmbartimit	Ariana Lito ( e komanduar që nga 2017)
Prefektura	Roland Nasto prefekt
Kryetarët e Njësive Administrative	Nuk ka
Zyra e Punësimit	Nuk është dhënë emir
Organizata Jo qeveritare	Fabiola Egro (QSHK) Bajana Cevoli (ShGPS)
Strehëzat për viktimat e dhunës	Nuk ka

<sup>4</sup>Bashkia Vlorë <http://bashkiavlore.org/transparenca/rregullorja/>

Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

**Burimi: Bashkia Durrës**

Në bazë të monitorimit në Bashkinë Durrës të gjitha UM dhe UMM-të janë plotësuar vetëm nga organi i Policisë dhe nga asnjë organ tjetër. Gjithashtu nuk rezulton që ndonjë OJQ, të cilat megjithëse ofrojnë ndihmë ligjore falas, të ketë plotësuar vetë UM ose UMM, por përfaqësues të OJF-ve kanë përfaqësuar viktimat në gjykatë sipas kërkesave. ShGPS ka përfaqësuar 15 raste UM/UMM, QNLQ 5 raste ndërsa QZHK nuk ka përgjigje.

Në vitin 2010, Bashkia Durrës ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me aktorët e mekanizmit të referimit. Kjo marrëveshje është në fuqi dhe ka të parashikuar edhe qarkullimin e titullarëve apo të specialistëve të cilët janë të ngarkuar me përgjegjësi në bazë të kësaj marrëveshjeje, gjë që nuk përbën arsye për të kërkuar rishikimin apo ndryshimin e saj. Kjo nënkupton që palët nënshkruese dhe zbatuese përfaqësojnë institucionin (dhe jo thjesht dëshirën apo angazhimin personal).

Gjatë vitit 2017 nuk është trajtuar asnjë rast në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje i ardhur nga Bashkia Durrës

Gjatë vitit 2017 bashkëpunimi me njësitë administrative mbetet i moderuar. Edhe pse Koordinatori Vendor u ka kërkuar administratorëve socialë t’i referojnë raste sipas të dhënave të mbledhura nuk rezulton se këta të fundit kanë marrë pjesë në mbledhje apo të kenë referuar raste konkrete. QZHKka mbështetur më shërbime ligjore dhe psikologjike raste të referuara nga specialisti i barazisë gjinore dhe dhunës në familje nga njësia administrative Manëz.

**Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.**

Përgjatë vitit 2017 Gjykata e Durrësit ka lëshuar 353 Vendime UMM, nga këto janë pranuar 239, janë rrëzuar 15 dhe pushuar 99. Pavarësisht këtij numri të lartë të urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga gjykata, Bashkia Durrës raporton menaxhim të suksesshëm të vetëm 14 rasteve të dhunës me bazë gjinore me UMM/UM për këtë vit. Përfshirja e këtij numri të lartë të personave që kanë marrë urdhër mbrojtjeje në shërbimet e ofruara nga bashkia është e domosdoshme.

Një mangësi e shërbimit të provës është mënyra e mbledhjes dhe publikimit të statistikave mbi dënimet alternative. Nuk bëhet ndarje sipas gjinisë dhe llojit të veprës penale, gjë që e bën të vështirë marrjen e informacionit mbi personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe llojin e dënimit alternativ që merret për ta. Vlen për t’u theksuar gjithashtu se nuk ka asnjë shërbim rehabilitimi për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje, kur në fakt, edhe shërbimet për viktimat janë tejet të kufizuara.

Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinitorit dhe kësaj strukture sepse koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për t’u trajtuar me programe të tilla. Koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuara të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit. Shërbimi i Provës nuk është anëtar i Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe si i tillë nuk ka detyrim ligjor të raportojë pranë koordinitorit vendor. Mekanizmi i Referimit të dhunës

ofron shërbime përmes institucioneve anëtare për viktimat e dhunës në familje, dhe jo për dhunuesit.

Çdo UMM që del nga Gjykata dorëzohet dorazi nëpërmjet postës pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale. Në momentin e dorëzimit firmosen nga Koordinatori Vendor. Megjithatë, ka pasur raste të mos dërgimit në kohë të UMM-ve që kanë cënuar qëllimin e emergjencës së tyre.

Gjykata e rrethit të Durrësit i publikon të dhënat e saj mbi rastet e ndjekura në gjykatë në mënyrë të detajuar në faqen e saj në internet. Këto të dhëna janë të ndara sipas veprës penale apo civile, sipas kohëzgjatjes së marrjes së vendimit si edhe nëse rastet janë të paraqitura së fundmi apo të mbartura nga vitet e kaluara. Këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas gjinisë dhe nuk ka detaje sa i përket çështjeve të dhunës në familje, të cilat mblidhen kryesisht nga drejtoria e policisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka të dhëna të sakta statistikore për UMM të pëcaktuara sipas vendbanimit; qytet, periferi apo fshat, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelit arsimor, statusit të punësimit. Gjithashtu kjo gjykatë ka të dhëna të hollësishme mbi vendimin dhe faktin nëse kërkesa për UMM është pranuar hedhur poshtë apo pushuar. Gjykata mban statistikë të lidhjes familjare të viktimës me dhunuesin, nëse viktimja ka marrë asistencë nga qendrat e specializuara dhe të faktit nëse është paraqitur ndonjëherë në institucione shtetërore për kërkimin e ndihmës. Nuk publikohen online të dhënat e UMM, ato dalin veç në shortin ditor, gjithashtu nuk publikohen online vendimet UMM. Çdo vendim tjetër gjendet online që nga viti 2008.

Duhet përmendur gjithashtu se mbledhja e të dhënave nga shërbimi i provës nuk bëhet në mënyrë të disagreguar sipas gjinisë apo sipas llojit të veprës penale. Të dhënat që janë të aksesueshme nga shërbimi i provës japin vetëm numrin total të personave që kanë marrë dënime alternative, pa vendosur detaje mbi llojin e veprës së kryer apo të ndarë sipas gjinisë. Kjo e vështirëson identifikimin e të dhënave mbi personat që marrin dënime alternative. Për shembull nuk është e mundur të kuptojmë nga statistikat e publikuara nga shërbimi i provës sa prej personave janë dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje. Përmbushja e objektivit 3.3 paraqitet më sfiduesja pasi është edhe objektivi specifik më pak i respektuar në implementimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

## **Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkinë Durrës**

Në bazë të monitorimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGj 2016-2020) në bashkinë e Durrësit, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëhershme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkinë Durrës dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGj, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- MKR-ja e bashkisë Durrës duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj duek patur parasysh numrin e madh të raportimeve për dhunën në familje si dhe të UM dhe UMM të dhëna nga bashkia.
- Bashkia dhe Polica duhet të bashkëpunojnë për cdo rast me rrezikshmëri të lartë. Koordinatori duhet të krijojë lidhje të vazhdueshme e të qendrueshme me policinë në kuadër të mekanizmit të referimit. Nuk duhet të ketë mungesë komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve për referimin sa më efikas të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Rritja e komunikimit ndërmjet këtyre dy

institucioneve është prioritare për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës.

- Bashkia e Durrësit duhet të ofrojë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore.
- Bashkia Durrës duhet të ndërtojë një qendër emergjence sa më parë dhe ta mbështesë me mjete financiare dhe burime njerëzore.
- MKR-ja Durrës duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimat, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Roli i NBGj është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe funksionimin e mekanizmit të referimit, ndaj është e domosdoshme të rishikohet struktura aktuale e bashkisë për të siguruar burimet e duhura financiare dhe kohore që ky peron ti dedikohet vetëm çështjeve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe çështjeve të barazisë gjinore.
- NBGj duhet të organizojë takime dhe të informojë të gjithë anëtarët e MKR-së në rastet kur ata ndërrohen për shkak të detyrës apo ndonjë arsyeje tjetër.
- Gjatë mbledhjeve duhet të mbahen minutat dhe të përgatiten skedat e të dhënave për rastet konkrete. Rastet të ndiqen deri në krijimin e bindjes se janë jashtë rrezikut të dhunuesit.
- Të gjitha institucionet pjesë e mekanizmit sipas LDhF duhet të përcaktojnë një përfaqësues të qendrueshëm dhe kompetent, të cilët duhet të marrin pjesë në të gjitha takimet e MKR-së. Të gjithë anëtarët e MKR-së këta duhet të marrin rol aktiv kundër dhunës me bazë gjinore.
- Komiteti Drejtues, duhet të mblidhet më shpesh përgjatë vitit kalendarik, duke qenë se 2017 ka rezultuar në shifra 0 të rasteve të këtyre mbledhjeve.
- Bashkia e Durrësit duhet të angazhohet në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Bashkia e Durrësit duhet të alokojë fonde për fletëpalosje dhe materiale të tjera informuese dhe ndërgjegjësues për qytetarët e Durrësit. Informacioni brenda këtyre materialeve duhet të hartohet në bashkëpunim me organizata e shoqërisë civile.
- Në përgjithësi, burimet njerëzore, financiare dhe operationale si të aktorëve publikë ashtu edhe jofitimprurës duhen bashkërenduar për të krijuar mekanizma të përbashkët për ofrimin e shërbimeve.
- Në bashkinë e Durrësit duhet të ndërtohet një sistem për trajtimin e dhunuesve në bazë të objektivit 3.3, për ndëshkimi e dhunuesve dhe dhënien e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.
- Mbledhja e të dhënave nga shërbimi i provës duhet bërë në mënyrë të disagreguar sipas gjinisë apo sipas llojit të veprës penale. Të dhënat që janë të aksesueshme deri më tani nga shërbimi i provës japin vetëm numrin total të personave që kanë marrë dënime alternative, pa vendosur detaje mbi llojin e veprës së kryer apo të ndarë sipas gjinisë. Kjo e vështirëson identifikimin e të dhënave mbi personat që marrin dënime alternative.
- KBGj duhet të hedhë të dhënat në kohë reale në sistemin REVALB.

## Aneksë

### Aneksi 1- Detyrat e koordinatorit për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje

- Të studiojë dhe përpunojë të dhënat për nevojat, problemet dhe gjithë situatën sociale mbi çështjet gjinore.

- Të mbrojnë gratë në nevojë brenda hapësirave që lejon ligji. Denoncon pranë organeve të drejtësisë rastet e keqtrajtimit, dhunimit të grave dhe dhunës në familje.
- Përpilon draft-projektet për ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare në ndihmë të këtij grupi në nevojë në bashkëpunim me OJQ të ndryshme për të ardhur me projekte të përbashkëta.
- Te advokojë dhe llojë për çështjet e barazisë gjinore në territorin e qytetit të Durrësit.
- Ka për detyrë që në vazhdimësi të punojë për rritjen e aftësive vetjake tekniko-profesionale në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar dhe të karrierës në shërbimin civil.
- Të mbajë sistemin e të dhënave për rastet e menaxhuara nga sistemi i reagimit të koordinuar në komunitet për rastet e dhunës në familje.
- Bashkërendimi i punës me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës dhe të mbrojtjes së rasteve që përjetojnë dhunë në familje.
- Koordinon dhe lehtëson takimet e Grupit Teknik Multidisiplinar për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të dhunës në familje në territorin e Bashkisë Durrës.
- Të ndjekë zbatimin e Planit Lokal të veprimit për Barazi Gjinore në Bashkinë Durrës.
- Të bashkëpunoj me qendrën dhe OJF të tjera me të cilat Bashkia Durrës ka marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e rasteve të dhunës për shërbimet ligjore, psikologjike dhe linjën telefonike.
- Të hartojë raporte periodike mbi rastet e menaxhuara.

## **Aneksi 2- Detyrat e të gjithë anëtarëve që kanë nëshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit si pjestarë të Mekanizmit të Rreferimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore**

### **Drejtoria e Policisë Qarkut Durrës, ka këto detyrime dhe përgjegjësi specifike:**

- *Të reagojë menjëherë ndaj të gjitha thirrjeve për dhunë në familje.* Paralelisht me të gjitha njoftimet që mund të marrë në numrin e telefonit 129, ose në numrat e tjerë që mund të disponojë për këtë qëllim, Drejtoria e Policisë Qarkut me të gjitha strukturat e saj nën varësi, ka detyrim të reagojë me prioritet kundrejt të gjitha thirrjeve që mund të marrë për dhunë në familje, veçanërisht nga antarët e sistemit të reagimit të koordinuar, si dhe nga Qendra Komunitare (nëpërmjet numrit të telefonit të kësaj Qendre 0692488208
- *T'i intervistojë viktimat të ndara nga autorët e dhunës dhe të tjerët.* Në këtë kuadër, intervistimi do të kryhet në bazë të të gjitha procedurave standarte të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe strukturat e saj, mund të mbështeten edhe tek burimet ekzistuese mes antarëve të tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar (njerëzore apo infrastrukturë).
- *Të mbledhë prova për incidentin në bazë të procedurave standarte të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes fotove, intervistave me dëshmitarët dhe me anë të teknikave të tjera investigative.* Sërish në këtë kuadër, personeli i policisë mund të mbështetet edhe tek antarët e tjerë të reagimit të koordinuar dhe njëkohësisht duhet të verë në dispozicion informacionin e mbledhur sipas nevojës tek antarët e tjerë (veçanërisht prokurori dhe gjykatë). Në çdo rast, punonjësit e policisë duhet t'ju japin udhëzimet përkatëse antarëve të tjerë të skuadrës, lidhur me ruajtjen e padëmtuar të provave në vendin e ngjarjes.



- *Të plotësojë dokumentimin e të hollësive të rastit.* Këtu mund të përdoren formularët Tip të policisë, miratuar edhe nga Ministria e Brendshme si dhe përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
- *Ta transportojë viktimën në një vend të sigurt ose ta largojë keqbërësin për të garantuar sigurinë e viktimës.* Këtu duhet të merret shumë në konsideratë siguria e viktimës dhe hapat duhet të kryhen në bashkëpunim dhe konsultim me Koordinatorin e Sistemit si dhe me Qendrën Komunitare, pa përjashtuar edhe aktorët e tjerë antarë të reagimit të koordinuar. Transportimi sipas rastit, mund të lehtësohet edhe nga antarët e tjerë të reagimit të koordinuar.
- *Të iniciojë koordinimin e skuadrës së reagimit, nëse kontaktohet e para.* Pavarësisht nëse e merr telefonatën e para apo njoftohet nga anëtarë të tjerë të reagimit të koordinuar, paralelisht me shkuarjen në vendngjarje dhe ndërhyrjen, policia duhet të marrë masa të menjëherëshme për të njoftuar antarët përgjegjës të skuadrës për reagimin e koordinuar (që veprojnë në nivel menaxhim rasti), pra Koordinatorin e Sistemit, Qendrën Komunitare dhe antarët e tjerë sipas rastit (shpjeguar në paragrafët më sipër të kësaj marrëveshjeje).
- *Ta informojë viktimën, ta ndihmojë në plotësimin e kërkesës si dhe në depozitimin e dosjes për marrjen e një urdhri mbrojtjeje, si dhe ta referojë atë tek antarët e tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar për shërbime të mëtejshme.* Ky hap është shumë i rëndësishëm dhe paralelisht me sigurimin e jetës së viktimës, ajo duhet të informohet për mundësitë që ka në bazë të ligjit (pra nuk duhet pritur të bëhet kjo gjë vetëm nëse viktima e kërkon, pasi duhet marrë në konsideratë fakti që viktima mund të mos ketë dijeni për masat ligjore ekzistuese). Njëkohësisht punonjësit e policisë duhet t'i ofrojnë asaj mbështetjen dhe ndihmën përkatëse për hartimin e kërkesës dhe plotësimin e dosjes për urdhër mbrojtjeje dhe duhet të merren me dorëzimin e kësaj dosjeje. Referimi tek shërbimet e tjera që ofrojnë antarët e sistemit të reagimit të koordinuar është sërish i rëndësishëm dhe ndjek dy hapat e para. Në varësi të rastit, policia mund të bashkëpunojë me avokatin/en e caktuar pranë Qendrës Komunitare për këtë qëllim, si dhe me Koordinatorin e Sistemit.
- *Të reagojë dhe të ndërhyjë ndaj shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes; Të nisë kontaktin me prokurorët për shkeljen e urdhrave; Të reagojë ndaj çdo raportimi të shkeljes së UM/UMM-së në kohën e duhur për të garantuar sigurinë e viktimave.* Policia duhet të ndërhyjë dhe përgjigjet në çdo kohë në rast konstatimi apo informimi për shkeljen e UMM apo UM, si në rastin kur vihet në dijeni direkt nga viktima, edhe në rastin kur informohet nga aktorët përgjegjës antarë të reagimit të koordinuar apo edhe më gjerë. Policia duhet të marrë të gjitha masat për të kontaktuar me prokurorët për shkeljet e urdhrave përkatës. Po kështu, policia duhet të shoqërojë viktimën dhe punonjësit përkatës të Zyrës së Përmbartimit gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit për UMM apo UM, me qëllim garantimin e sigurisë së viktimës si edhe të institucioneve të tjera antare të reagimit të koordinuar.
- *Të plotësojë dhe të dërgojë dokumentacionin për çështjen penale kur është rasti për përgjegjësi penale.* Paralelisht me sa më sipër, policia duhet të punojë edhe për plotësimin e dokumentacionit për hapjen e një çështjeje penale, nëse është e mundur, si dhe dërgimin e këtij dokumentacioni përkatës në Prokurori. Në çdo rast, vlerësimi i situatës bëhet duke u nisur nga nocioni i viktimës në qendër, duke synuar kështu garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e të drejtave të saj. Në kryerjen e kësaj detyre, policia respekton parimin e barazisë së shtetasve, duke mos diskriminuar për asnjë shkak, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, prejardhjes etnike, gjendjes civile apo faktit që vepra ka ndodhur në kuadrin familjar.
- *Të vlerësojë nevojën për kujdes mjekësor dhe nevoja të tjera urgjente dhe të kryejë transportin nëse është e nevojshme.* Paralelisht me veprimet e përshkuara më sipër, duke bashkëpunuar edhe me antarët e tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar, apo në rast

kërkese nga viktimat, policia duhet të vlerësojë nevojën për kujdes mjekësor si dhe duhet të mundësojë transportimin e viktimës në qendrën spitalore përkatëse.

- *Të garantojë që i gjithë personeli i policisë të trajnohet në reagimin ndaj dhunës në familje, ku përfshihen: punonjësit, oficerët dhe të gjithë reaguesit.* Në kuadër të ndërhyrjeve të mësipërme, policia duhet të informojë vazhdimisht Koordinatorin e Sistemit si dhe Qendrën Komunitare për nevojat që mund të kenë / apo mund të identifikojnë për trajnim, me qëllim përmirësimin e njohurive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Po kështu, herë pas here policia duhet të jetë e gatshme t'ju nënshtrohet vlerësimeve për identifikimin e nevojave për trajnim, qofshin këto nga Ministria e Brendshme, apo edhe të iniciuara nga sistemi i reagimit të koordinuar.

Në kuadër të këtyre përgjegjësiave dhe detyrimeve të Drejtorisë së Policisë Qarkut si dhe strukturave të saj, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a) Të njoftojnë në çdo kohë dhe sipas rastit policinë për çdo denoncim dhe nevojë për ndërhyrje në rastet e dhunës në familje;
- b) Të koordinojnë veprimet bashkarisht për të shkuar në vendngjarje;
- c) Të lehtësojnë punën e organeve të policisë nëpërmjet mbështetjes me burime të ndryshme në dispozicion, në funksion të menaxhimit të rastit (burime njerëzore, transport, infrastrukturë, etj);
- d) Të identifikojnë, adresojnë dhe mbështesin policinë në lidhje me nevojat e ndryshme për trajnimin e stafit përkatës për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të lëshojë urdhra mbrojtjeje në kohën e duhur për të garantuar sigurinë e viktimës.* Në këtë kuadër, Gjykata e Durrësit merr masa për të shqyrtuar kërkesat për urdhëra mbrojtjeje në çdo kohë dhe bazuar në parashikimet në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare”. Për rastet jashtë orarit zyrtar të punës, kjo Gjykatë organizon shërbimin e gjyqtarit/es së gatshëm/e për shqyrtimin e kërkesave për UMM. Më konkretisht, kërkesat për urdhëra mbrojtjeje mund të dorëzohen nga ??? Këto kërkesa do të merren në shqyrtim dhe do të lëshohen urdhërat përkatës bazuar në ligjin në fuqi.
- *Të ndihmojë viktimat në kuptimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të proceseve të gjykatës.* Në këtë kuadër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës duhet të marrë të gjitha masat me qëllim informimin e viktimave, vënien në dispozicion të formularëve të caktuar (kërkesë-padive për urdhërat mbrojtës), si dhe vënien në dispozicion të tyre të një informacioni shpjegues për hapat dhe procedurat që mund dhe duhet të ndjekin. Organizimi i brendshëm i Gjykatës për depozitimin e kërkesës për urdhëra mbrojtjeje duhet parë me prioritet dhe duke respektuar urgjencën e rastit. Në këtë drejtim, Gjykata mund dhe duhet të bashkëpunojë edhe me anëtarët e tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar, me qëllim informimin e sa më shumë qytetarëve. Në mënyrë specifike, informacioni i ofruar duhet të përmbajë të dhëna për orarin, vendin si dhe mënyrën se si mund të gjenden dhe plotësohen formatet për kërkesën për lëshimin e urdhërave mbrojtës.
- *Të ofrojë mbrojtjen e plotë të mundshme për viktimat e dhunës në familje.* Kjo nënkupton një shikim sa më të detajuar të kërkesës së paraqitur për urdhëra mbrojtës, me synimin arritjen e sigurisë së viktimës dhe në të njëjtën kohë dhënien e mundësisë për mbrojtjen e plotë të saj.
- *Të rrisë masat e sigurisë në godinë,* për të garantuar mbrojtje për viktimën/at, gjyqtarin/en, si dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e shqyrtimit të kërkesave për UM dhe UMM.

- *Të marrë pjesë në Reagimin e Koordinuar të Komunitetit dhe të sigurojë informacionin kyç dhe drejtimin për anëtarët e tjerë, për të garantuar procedurë efikase brenda gjykatës për viktimat; Në këtë kuadër, pjesëmarrja e një përfaqësuesi të Gjykatës në mbledhjet në nivel vendim-marrjeje të reagimit të koordinuar të komunitetit, nuk duhet parë me syrin e shkeljes së paanshmërisë së këtij institucioni, por me synimin e përmirësimit të shërbimeve të ofruara kundrejt viktimave të dhunës në familje, si dhe me idenë e rritjes së aksesit të këtyre viktimave (veçanërisht grave), në sistemin e drejtësisë.*

Në kuadër të këtyre përgjegjësiave dhe detyrimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjitha palët e tjera në këtë memorandum bien dakort:

- a) Të informojnë të gjitha viktimat e dhunës në familje, por edhe komunitetin më gjerë, për mundësitë dhe mënyrën e kontaktimit të personave/strukturave përkatëse në rastin e nevojës për dorëzimin e kërkesë padisë për lëshimin e urdhrave mbrojtës. Më konkretisht aktorët e reagimit të koordinuar marrin përsipër të sensibilizojnë komunitetin në lidhje me faktin që dorëzimi i formateve të kërkesë - padisë për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes bëhet cdo ditë nga ora 8.00 deri në 16.00 tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
- b) Të marrin në konsideratë sugjerimet e mundshme nga Gjykata në lidhje me përshpejtimin/saktësimin e procedurave të caktuara përsa i takon UM dhe UMM;
- c) Të konsultohen herë pas here me ekspertët e Gjykatës në lidhje me rastet specifike të dhunës në familje, si dhe mënyrat më të mira të mundshme të trajtimit/zgjidhjes së tyre.

### **Prokuroria e Rrethit Durrës, ka këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të sigurojë një analizë të çështjeve ligjore të paraqitura.* Në këtë kuadër, Prokuroria në vijim të përmbushjes së këtij detyrimi, merr përsipër edhe mbledhjen e kujdesshme të provave përkatëse, sikurse dhe ndarjen e informacionit të kërkuar (shpjeguar edhe në paragrafët e mësipërm të kësaj marrëveshjeje) mes antarëve të tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje.
- *Të përcaktojë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe ndjekjen efikase të rastit; Të marrë pjesë në përpjekjen e përbashkët dhe të ndihmojë me zgjidhjen e çështjeve që ngrihen; Të jetë i gatshëm 24 orë në ditë për 7 ditët e javës për ndërhyrjen në rastet e shkeljes së urdhrave të mbrojtjes ose të rasteve të tjera më serioze të dhunës.* E rëndësishme në përmbushjen e këtyre detyrimeve është veçanërisht angazhimi për trajtimin me seriozitet, efektivitet dhe në kohë sidomos të rasteve të shkeljes/thyerjes së urdhërave mbrojtës, me qëllim krijimin e një praktike të mbrojtjes më të mirë të viktimave dhe respektimit maksimal të drejtësisë së vendosur përmes vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuadër, për kontaktime dhe detaje të mëtejshme mbi rastet, prokuroria vë në dispozicion të viktimave të dhunës në familje, apo sistemit të reagimit të koordinuar, mundësinë e kontaktimit përmes znj. Rabiana Halili tel 0694113464, cdo ditë nga ora 8.00 deri në orën 16.0
- *Të ofrojë ndihmë dhe këshillim ligjor për Reagimin e Koordinuar të Komunitetit, gjë e cila do të përmirësojë llojet e rasteve që janë paraqitur.* Duke pasur parasysh specifikat për mbledhjen e të dhënave dhe trajtimin e çështjeve penale, ka shumë rëndësi këshillimi i të gjithë antarëve të skuadrës së reagimit të koordinuar dhe në veçanti i Qendrës Komunitare, mbi mënyrën se si mund të mblidhen faktet dhe të adresohen në mënyrë specifike llojet e rasteve të dhunës në familje.
- *Të ndihmojë viktimat me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje; Të informojë viktimat për mënyrën e depozitimit të akuzave penale, për dokumentacionin që nevojitet dhe për veprimet që ata duhet të kryejnë që çështjet të përparojnë.* Sërish në vijim të pikës

së sipërpërmendur, Prokuroria luan një rol shumë të rëndësishëm veçanërisht për informimin e viktimave mbi mënyrën se si mund të depozitohen akuzat penale, dokumentacionin që duhet të plotësojnë dhe paraqesin, etj. Këtë përgjegjësi mund ta përmbushë më së miri në bashkëpunim me mbështetjen e avokatit të punësuar pranë Qendrës Komunitare, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

*Në kuadër të këtyre përgjegjësi dhe detyrimeve të Prokurorisë Durrës, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:*

- a) Për raste specifike të dhunës në familje, apo për denoncimin dhe ndjekjen e rasteve penalisht, të mbajnë kontakte të ngushta dhe të vazhdueshme me Prokurorinë përmes z/znj.Rabiana Halili tel.0694113464, çdo ditë nga ora 8.00 deri në orën 16.00 (prokuroria). Sipas kontaktit me prokurorinë rezultojnë që ata funksionojnë në bazë të prokurorëve të gatshëm dhe Prokurorja në fjalë nuk merret specifikisht me rastet e dhunës. Në Prokurorinë e Durrësit ekziston seksioni ë për të miturit dhe jo ai përcështjet me bazë gjinore në veçanti
- b) T'ju komunikojnë viktimave apo personave të interesuar mënyrën e kontaktimit apo të ndjekjes së rasteve përmes Prokurorisë, duke vendosur paralelisht kontakte me këta të fundit.
- c) Të marrin në konsideratë sugjerimet për përmirësimin e funksionimit me efektivitet të sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje, veçanërisht kur bëhet fjala për ndjekjen e rastit penalisht, apo për shkelje të urdhërave të mbrojtjes.

**Urgjencat Mjekësore, Qendrat Shëndetësore dhe Spitali i Durrësit, kanë këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të sigurojnë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës; Kjo nënkupton që menjëherë me paraqitjen e një rasti të dhunës në familje, spitali, apo qendra e kujdesit shëndetësor parësor apo urgjenca, të vihen në dispozicion të trajtimit të rastit me prioritet dhe kundrejt të gjitha procedurave e standarteve përkatëse. Njëkohësisht, për çdo rast të paraqitur drejtpërsëdrejti në spital (pra ku këto qendra të kujdesit janë pika e parë e kontaktit me viktimën), të venë në dijeni Koordinatorin e Sistemit, psikologun e Qendrës Komunitare, si dhe Policinë. Në këtë kuadër, Spitali vë në dispozicion si person kontakti z. Taulant Baku me të cilën mund të kontaktohet çdo ditë nga ora 8.00 deri në orën 14.00 nëpërmjet numrit 222222.*
- *T'u japin dokumentacionin mbi lëndimet dhe raportet e sakta viktimave dhe në bazë të kërkesës edhe gjykatave. Në kuadër të plotësimit të këtij detyrimi, ka shumë rëndësi njohja e personelit dhe kërkimi i plotësimit në mënyrë të detyruar të formateve përkatëse të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë me qëllim mbajtjen shënim të rasteve të dhunës në familje. Një kopje e raportit të vizitës duhet t'i jepet në çdo rast viktimës (apo shoqëruesit/es së saj). Ndërkohë këto struktura shëndetësore duhet të zbatojnë edhe detyrimin për raportimin mujor të rasteve, bazuar në respektimin e konfidencialitetit, si edhe në masat që do merren në vijim të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.*
- *T'i ndjekin viktimat për nevojat e tyre shëndetësore dhe të sigurojë shëndetin e tyre. Në këtë kuadër, të gjitha strukturat shëndetësore të mësipërme, duhet të mbajnë marrdhënie të vazhdueshme me Qendrën Komunitare dhe me Koordinatorin e Sistemit, sikurse dhe të marrin në konsideratë e të ndjekë vazhdimisht rastet që referohen nga këto të fundit, apo edhe nga antarë të tjerë të reagimit të koordinuar.*
- *Të marrin pjesë në Reagimin e Koordinuar të Komunitetit për të ofruar lidhjen mjekësore dhe perspektivën për zhvillimin e një reagimi të plotë për viktimat. Në këtë kuadër,*

strukturat shëndetsore të mësipërme duhet të ofrojnë vazhdimisht konsulenca dhe perspektivën se si mund të trajtohet më mirë shëndeti i viktimave të dhunës në familje, nisur nga shembujt e rasteve të menaxhuara.

- *Të trajtojnë personelin tjetër mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, pa i bërë publik emrat e tyre.* Nga kjo pikpamje ka shumë rëndësi evidentimi i nevojave specifike për trajnim apo materiale, bazuar edhe në Protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë (formularë, rregullore, urdhërat përkatës në funksion të zbatimit të Ligjit 9669, etj), si dhe më pas adresimi i tyre tek Koordinatorja e Sistemit dhe antarët e reagimit të koordinuar të komunitetit, me trajtimin dhe qëllim plotësimin e tyre.

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Drejtorisë së Shëndetit Publik, strukturave në varësi të saj dhe Spitalit Durrës, të gjitha palët e tjera në këtë memorandum bien dakort:

- a) Të kontaktojnë menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të rastit me personin e kontaktit të përcaktuar nga strukturat shëndetsore;
- b) Për rastet e dhunës në familje, të bëhen lidhjet me strukturat shëndetsore përkatëse në varësi të zonave ku ndodh ngjarja.

### **Drejtoria Arsimore Rajonale e Durrësit ka këto përgjegjësi dhe detyrime:**

- *Zhvillimi i kurrikulave; Integrimi në kurset ekzistuese; Garantimi që çdo nxënës të njohë dhe të informohet për dinamikën, për incidentet, për ligjin dhe burimet lidhur me dhunën në familje.* Në këtë kuadër, Drejtoria Arsimore merr përsipër të fokusohet për vitin 2010, veçanërisht në shkollat 9-vjeçare apo të mesme, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rastet e dhunës në familje.
- *Trajnimin e mësuesve në lidhje me identifikimin, reagimin, burimet dhe ndjekja e rasteve të dhunës në familje.* Përveçse vënies në dispozicion të mësuesve me qëllim pjesëmarrjen në kurse të tilla kualifikuese, Drejtoria Arsimore merr përsipër edhe emërimin e një punonjësi social/psikologu në shkollat e sipërpërmenduar (ose kualifikimin e tyre veçanërisht në identifikimin e rasteve të dhunës në familje) – Drejtoria Arsimore të shtojë apo përshtasë çfarë hapash mund të ndërmerret në funksion edhe me planine saj vjetor.
- *Të raportojnë rastet e identifikuar të dhunës në familje, tek Koordinatorja e Sistemit.*
- *Të kujdesen për zbatimin e urdhërave mbrojtës, kur këto përcaktojnë detyrime për dhunuesin për të mos kontaktuar fëmijët apo për të mos iu afruar godinave të tyre arsimore (kopshte, shkolla, etj).* Në rast të shkeljes së këtyre urdhërave mbrojtës, drejtuesi/ja i institucionit duhet të njoftojë menjëherë policinë dhe Koordinatorin e Sistemit.

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Drejtorisë Arsimore Rajonale Durrës, të gjitha palët e tjera në këtë memorandum bien dakort:

- a) Të bashkëpunojnë me Drejtorinë Arsimore dhe personelin e strukturave arsimore përkatëse veçanërisht në organizimin e fushatave ndërgjegjësuere për dhunën në familje;
- b) Të koordinohen me këto struktura kur bëhet fjalë për identifikimin dhe trajtimin e rasteve specifike;
- c) Në rast nevojë për zhvendosje të viktimës nga banesa dhe territori i saj, të koordinohen me Drejtorinë Arsimore me qëllim sistemimin sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të zgjedhur e të sigurt të fëmijëve në shkolla të tjera, me qëllim vijimin normal të procesit mësimor.

### **Zyra Rajonale e Punësimit, ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të përfshijë dhe trajtojë me prioritet të gjitha rastet e viktimave të dhunës në familje, në programet për nxitjen e punësimit dhe formimit profesional;
- Të marrë masa në sistemin e këtyre viktimave në programe të caktuara të formimit profesional, varësisht nevojave të tyre;
- Të shqyrtojë me prioritet dhe procedura të përsheptuara të gjitha rastet e dhunës në familje që referohen nga sistemi i reagimit të koordinuar;
- Në rast identifikimi/konstatimi të një situatë të dhunës në familje, të bëjë menjëherë informimin dhe referimin në antarët e sistemit të reagimit të koordinuar, sikurse është shpejtuar në paragrafët e mësipërm të kësaj Marrëveshjeje;
- Të ndihmojë në sensibilizimin dhe informimin e komunitetit dhe veçanërisht të grave dhe vajzave, mbi sistemin e reagimit të koordinuar të ngritur në Durrës, si dhe mbi mbrojtjen dhe ndihmën që mund t'ju ofrohet viktimave të dhunës në familje, nga ky sistem, si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Të identifikojë dhe adresojë nevojat për trajnimin e personelit veçanërisht në lidhje me komunikimin, krijimin e besimit si dhe informimin e referimin e rasteve të dhunës në familje.

### **Zyra e Përmbartimit ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës në lidhje me urdhërat mbrojtës;
- Të kërkojë ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të urdhërave apo në rast shkeljeje të tyre;
- Të prioritarizojë dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme , veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.

### **Mjeku Ligjor ka këto detyrime dhe përgjegjësi specifike:**

- Të marrë masa për ekzaminimin e menjëhershëm dhe sipas parametrave të kërkuar, të viktimave të dhunës në familje që i paraqiten;
- Të vijojë me procedurat përkatëse për/pas ekzaminimit mjeko-ligjor, duke prioritarizuar raste e dhunës në familje;
- Të prioritarizojë dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.

### **Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Emërimin e një avokati/eje dhe një psikologu/eje si dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse ligjore dhe psikologjike, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, bazuar në akt-marrëveshjen nr. Prot 984 datë 01.03.2010, e lidhur me Bashkinë, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Të dhënat dhe mënyra e kontaktimit të këtyre dy profesionistëve duhen vënë në dispozicion të Bashkisë *jo më vonë se pesë ditë nga data e nënshkrimit* të akt-marrëveshjes për kontraktimin e shërbimeve të mësipërme.
- Të vërë në dispozicion të mbledhjes së informacionit për raste të dhunës në familje, si dhe referimin e këtyre rasteve në aktorët përgjegjës, numrin e telefonit 0800 98 88 . Ky numër telefoni funksionon 24 orë në çdo ditë të javës. Qendra ka përgjegjësi që të vendosë një person korrekt dhe të mirë informuar me mënyrën e pritjes së telefonatave të tilla. Gjithashtu, personi që pret telefonatat, duhet të jetë i pajisur me një format për mbajtjen e shënimeve të nevojshme në lidhje me rastin, si dhe me listën e personave që duhet të kontaktojë për ndërhyrje, në varësi të rastit.

- QZHK ka përgjegjësinë e adresimit të menjëhershëm të informacionit të marrë për rastet e dhunës, tek skuadra që duhet të paraqitet menjëherë në vendngjarje. Kjo skuadër dhe njoftimi/adresimi i menjëhershëm i informacionit, përfshin në mënyrë të detyrueshme, këta antarë: 1. Punonjës/in/en e policisë së Komisarariatit apo të Sektorit kundër Dhunës në Familje pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut; 2. Psikologu/ia i/e QZhK “Sot për të Ardhmen”, caktuar për trajtimin e rasteve të tilla; 3. Koordinatorja e Sistemit pranë Bashkisë, 4. Urgjenca mjekësore e zonës përkatëse. Ndërkohë, në varësi të rastit, pra në rast të marrjes së informacionit për dëmtime shëndetësore, prani të fëmijëve, etj, në skuadrën që duhet të paraqitet në vendngjarje njoftohen edhe Specialistja e Njësisë së Mbrojtjes së Familjëve, Spitali, etj.
- Në bashkëpunim me Policinë dhe Koordinatorin e Sistemit, QZHK ka përgjegjësinë e organizimit të skuadrës së ndërhyrjes sipas rastit (sidomos në rastet emergjente), si dhe të shkuarjes menjëherë në vendngjarje. Koordinimi për mënyrën e shkuarjes në vendngjarje si dhe për transportin e viktimës, do të bëhet në mirëkuptim dhe marrëveshje me secilin aktor të përfshirë, si dhe në varësi të burimeve në dispozicion. Specialistët e sipërpërmendur do të paraqiten menjëherë në vendngjarje. Në çdo rast, hyrja në banesë apo vendin e ngjarjes, bëhet vetëm në prani të policisë si dhe duke ndjekur udhëzimet e tyre lidhur me ruajtjen e vendit të ngjarjes. Në çdo rast, asnjë vendim i marrë (apo i pamarrë) nuk i duhet të çënojë sigurinë e viktimës dhe efektivitetin e ndërhyrjes.
- Mbajtjen e një raporti të detajuar dhe në varësi të ndërhyrjeve të bëra për menaxhimin e rasteve të paraqitura. QZhK duhet të jetë e mirëinformuar në çdo moment për antarët e reagimit të koordinuar si dhe për burimet/mundësitë e tyre për të trajtuar rastet e dhunës në familje, me qëllim koordinimin rast pas rasti, në bashkëpunim edhe me Koordinatorin e Sistemit. Çdo detaj duhet të reflektohet në raportin përkatës, së bashku me arritjet dhe vështirësitë e ndeshura në çdo hap.
- Identifikimin dhe adresimin e nevojave për trajnim, në bashkëpunim me Koordinatorin e Sistemit, si brenda stafit të saj ashtu edhe tek antarët e reagimit të koordinuar, me të cilët QZhK bashkëpunon rregullisht për menaxhimin e rasteve.
- Ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv kundrejt viktimave të dhunës në familje, por edhe kundrejt antarëve të reagimit të koordinuar, bazuar në të gjitha rregullat dhe standartet përkatëse.

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të QZhK, të gjitha palët e tjera në këtë memorandum bien dakort:

- e) Të bëjnë të njohur mes stafit përkatës, Qendrën Komunitare dhe numrin e telefonit të saj 08009888 si dhe të udhëzojnë marrjen në konsideratë me prioritet të çdo njoftimi/telefonate/informacioni nga kjo Qendër;
- f) Të lehtësojnë në koordinimin e veprimeve për trajtimin e rasteve, duke vënë në dispozicion stafin përkatës përgjegjës, si dhe çdo burim tjetër në funksion të zgjidhjes së situatës (transport, telefon, punonjës mbështetës, etj).
- g) Të ndërhyjnë menjëherë në rast nevojë dhe të punojnë si ekip, duke mos u fokusuar thjesht tek përgjegjësitë specifike, por ta trajtojnë rastin në një këndvështrim multidisiplinar).
- h) Të mbajnë shënimet / të dhënat përkatëse për rastin, bazuar në detyrimet (formatet / raportimet) e tyre specifike dhe të venë në dispozicion informacionin rregullisht, në bazë të parimeve të konfidencialitetit, sikurse dhe në funksion e zbatim të mbledhjes dhe

qarkullimit të të dhënave, bazuar në paragrafët përkatës të cituar më sipër në këtë marrëveshje.

- i) Të referojnë pranë QZhK, rastet e dhunës në familje që mund të ndeshin dhe që kanë nevojë për trajtime më specifike në fushat që kjo qendër mbulon.

### **Ndërkohë bashkia ka dhe 2 marrëveshje bashkëpunimi të veçanta dhe me Shoqatën e Grave me Probleme Sociale Durrës.**

ShGPS në këtë marrëveshje merr përsipër këto angazhime:

- Të bashkëpunojë me Bashkinë Durrës dhe institucionet në varësi, për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në kuadër projektit “Qendra Sociale për Gra dhe Vajza”, në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.
- Të mbështesë Bashkinë Durrës në fuqizimin e strukturave të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, gra dhe fëmijë.
- Të mbështesë strukturat në nivel Bashkie në ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e nevojave të këtij targetgrupi – gra dhe fëmijë viktimat të dhunës në familje - si dhe për ndërtimin e planeve të ndërhyrjes.
- Të bashkëpunojë me Bashkinë Durrës për sigurimin e vazhdimësisë në ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e dhunës në familje.
- Të organizojë aktivitete të kordinuara për të nxitur rritjen e përgjegjësive dhe kapaciteteve të administratorëve vendor lidhur me sferën e shërbimeve sociale
- Informim për kornizën ligjore në mbrojtje të viktimave të dhunës, duke kordinuar punën me përfaqësuesit e njësive vendore dhe duke ruajtur lidhje me funksionet e Zyrës së Barazisë Gjinore
- Trajnime me administratorët vendorë lidhur me çështjet e dhunës në familje dhe pabarazitë gjinore
- Do të ruajë lidhje me përfaqësues të njësive vendore dhe Zyrës së Barazisë Gjinore, për të rritur kapacitetet e tyre, si dhe për të ofruar mbështetje për politikën dhe strategjitë në këtë kontekst.
- Do të monitorojë mekanizmin e sistemit të referimit të dhunës pranë Bashkisë Durrës